

„Nënë, çka është spitali?“

Si duhet ta përgatisni fëmijën tuaj për shtrim në spital.

Bisedoni me fëmijën për tema të tilla si sëmundja, fatkeqësia dhe spitali, edhe kur nuk ekziston një shkas direkt.

Në rastin e një shtrimi të pritshëm në spital, fëmija i juaj duhet të dijë se çfarë e pret në spital dhe çfarë do të ndodhë atje me të. Një informacion në pajtim me moshën dhe gjendjen e fëmijës suaj përbën një ndihmë më shumë për të eliminuar frikërat, dhe për të siguruar besimin dhe sigurinë. Nuk është gjithmonë e thjeshtë të gjenden fjalët e duhura. Një rregull ndihmëse e padiskutueshme është: mos kurseni gjë, por as mos dramatizoni! Transmetoni qetësi dhe besim.

Në rast se fëmija i juaj tashmë është paksa më i madh, keni mundësi të ndryshme që ta përgatisni për një qëndrim të gjatë apo të shkurtër në spital. Shumë nga spitalet për fëmijë ose reparalet përkatëse për fëmijë mund t'i njihni bashkë me fëmijën tuaj gjatë një vizite me përcjellje ose në një pasdite loje. Bisedoni më pas me fëmijën tuaj lidhur me mbresat e tij, me shqetësimet dhe shpresat. Përpiquni që t'u përgjigjeni sa më shumë pyetjeve.

„Jo pa arushin tim!“

Kështu ia lehtësoni fëmijës tuaj hyrjen në spital.

Për fëmijët e çdo moshe një qëndrim spitalor përbën një përvojë mbresëlënëse të thellë. Ata shpesh dalin nga ekuilibri dhe papritur nisin të sillen krejtësisht ndryshe nga sa në shtëpi. Ambienti i pazakonshëm, fytyra të shumta, të panjohura, kanë



ndikim frikësues. Shumë nga ta kanë frikë nga dhimbjet ose nga ndarja prej prindërve, ata frikësohen nga trajtimi ose nga një ndërhyrje e domosdoshme.

Për këtë shkak është më mirë që ju ose një person tjetër përgjegjës i afërt të rriini me fëmijën. I merrni me vete lodrat e tij të preferuara, arushin, kukullën më të dashur ose batanijen prej pelushi. S'ka gjë edhe po të jenë të vjetra a të dëmtuara, ngaqë ato i japin fëmijës suaj ndjenjën e sigurisë familjare.

„Mos më lër vetëm!“

Si i ofroni fëmijës suaj shoqërim dhe mbështetje.



Edhe parapërgatitja më e mirë nuk e bën të tepërt praninë e prindërve apo të një personi tjetër të afërt, përkundrazi, kjo gjë e lehtëson qëndrimin në spital për të gjithë pjesëmarrësit. Kjo ka sidomos rëndësi në rastin e një fatkeqësie që ju ka zënë të papërgatitur fëmijën dhe juve.

Është mirë nëse fëmija i juaj e di se do të shoqërohet nga prindërit apo nga kujdestari.

Bebet dhe fëmijët e vegjël akoma nuk e kuptojnë se përse u duhet të shkojnë dhe të qëndrojnë në spital, prandaj aq më shumë ka rëndësi që të qëndroni me ta.

Fëmijët më të rritur ose të rinjtë ndoshta s'kanë më nevojë që të kalojnë natën bashkë me ta në spital një person përgjegjës. Megjithatë, varësisht nga lloji i sëmundjes, ata ndoshta do të vlerësojnë bashkëpranimin e ndonjërit prej prindërve. Në secilin rast, pikëpamjet dhe dëshirat e fëmijës duhen marrë seriozisht dhe duhen respektuar.

„Rri me mua!“

Si ta kaloni natën tek fëmija i juaj.

Pothuajse në të gjitha spitalet prindërit mund ta kalojnë natën me fëmijët e tyre ("Rooming-in"). Kryesisht, afër krevatit të fëmijës do të vendoset një shtrat portativ. Fëmija do ta ndjejë afërsinë tuaj, do të ndjehet më pak i braktisur, dhe nuk do të jetë vetëm po të zgjohet gjatë natës. Natyrisht që në spital s'mund të prisni komfortin e një hoteli, kryesorja është shoqërimi i fëmijës suaj të sëmurë gjatë një sprove të rëndë jetësore.

Jo gjithmonë inkurajohen prindërit për të qëndruar në spital. Prandaj është e domosdoshme që këtë dëshirë ju ta shprehni qartë dhe shkoqur. Nëse për shkaqe familjare ose për shkaqe të tjera ju nuk mund t'i rriini pranë fëmijës, kjo gjithashtu duhet respektuar.

Shpenzimet për bujtjen tuaj në spital, për shujtat dhe pijet, janë rregulluar në mënyra krejt të ndryshme, në disa raste ato merren përsipër krejtësisht ose pjesërisht nga spitalet. Sqaroheni këtë problem përpara se të hyni në spital.



„Kur do të vish prapë?“

Vizitat janë një rreze shprese në përditshmërinë e një spitali.

Për fëmijët e çdo moshe është me rëndësi që të vizitohen rregullisht në spital, që ta ndjejnë afërsinë dhe mbështetjen e familjes, të miqve ose të shokëve të klasës.

Të gjithë ata që nuk i përkasin rrethit të ngushtë familjar, i përmbahen me këtë rast orarit të rregullt për vizita dhe

nuk vijnë të gjithë përnjëherësh. Përpiquni që këto kontakte të rëndësishme për fëmijën tuaj t'i bashkërendisni asisoj që ai mundësisht për çdo ditë të mund t'i gëzohet një vizite.

Për ju dhe për personat tjerë kujdestarë këto vizita paraqesin një rast të mirë për t'i kushtuar pak kohë vetes dhe për t'u çlodhur.

Në rastin e një qëndrimi të gjatë në spital përkujdesja vetëm personale e fëmijës suaj mund të shndërrohet në një barrë të padurueshme. Mos ngurroni që t'u kërkonin ndihmë gjyshit e gjyshes, vëllezërve e motrave më të mëdha, nunëve apo personave tjerë të afërm e të besueshëm, me qëllim që edhe ju të mund të rikarikoheni (ta merrni veten).



„Babi, unë kam frikë!“

Si mund ta qetësoni dhe ta ndihmoni fëmijën tuaj gjatë kontrolleve dhe përgatitjes për narkozë.

E shoqëroni, sa herë që të jetë e mundur, fëmijën tuaj gjatë kontrolleve, merrni me vete një „kafshë“ prej pelushi ose kukullën e preferuar dhe ndoshta edhe ndonjë libër nga i cili mund t'i lexoni diçka. Në rast se fëmija i juaj ka frikë dhe reziston kundër një ndërhyrjeje, përpiquni që me durim, me të folur të qetë dhe me dredhi devijuese t'ia hiqni frikën.

Mos e merrni pozicionin „e tjetrit“, ju jeni personi që gëzon besimin e tij dhe që në këtë situatë të vështirë i mban krahun dhe e ngushëllon.

Duhet shmangur masat shtrënguese, p.sh. kapërthimi me duar apo të lidhurit. Në situata kritike mjekët dhe infermierët me përvojë aplikojnë strategji të ndryshme të sprovuara që ndihmojnë fëmijën për ta tejkaluar frikën e tij. Kontrolli mundet që edhe të shtyhet, me qëllim që, gjatë një shëtitjeje, të mund të bisedoni edhe një herë në qetësi me fëmijën tuaj. Ose mjeku mund ta kontrollojë më parë arushin. Në kohën e sotme në shumë raste hiqet dorë nga gjilpëra (injeksioni), ose përdoret një farë llape (flasteri) dhimbje-zbutëse me ndikim lokal, pas së cilës dhimbja nga shpimi as që ndjehet fare.

Prania juaj gjatë përgatitjes për anestezi dhe në çastin e zgjimit i ndihmon fëmijës për ta përballuar frikën. Ndërkaq jo në të gjitha spitalet mund të qëndrojnë prindërit afër fëmijës së tyre gjatë inicimit të narkozës apo në dhomën e zgjimit. I sqaroni këto çështje me rëndësi para shtrimit në spital, dhe po të jetë e mundur, zgjidhni

një spital që lejon praninë e prindërve.

Për shkaqe familjare ose të tjera disa prindër nuk e kanë gjithmonë mundësinë që t'i qëndrojnë pranë fëmijës së tyre. Vetëkuptohet që edhe ky fakt duhet respektuar.



„Çfarë mund të bëj unë?“

Prindërit dhe personat përgjegjës mund t'i kontribuojnë shumë përkujdesjes optimale.

Kush rri pranë fëmijës në spital duhet informuar prej personelit përkujdesës (infernierik) lidhur me detyrat rutinore të ditës, dhe atje ku duket e arsyeshme, të angazhohet në përkujdesje. Gjatë një bisede të përbashkët sqaroni se çfarë pritët prej jush dhe cilat janë dëshirat dhe qëllimet tuaja.

Në rast se pas daljes nga spitali janë të domosdoshme edhe ca masa të caktuara të përkujdesjes në shtëpi, në spital keni mundësinë që ta mësoni këtë përmes drejtitimit të ndonjë motre medicinale me përvojë.

Ju e njihni fëmijën tuaj më së miri dhe shpesh jeni e para që vëreni nëse diçka nuk është në rregull. Prandaj mos ngurroni fare që t'i drejtoheni menjëherë personelit, në rast se keni ndjesinë që fëmija i juaj ka dhimbje ose se reagon në mënyrë të pazakonshme.

Po të keni bindjen se diçka nuk funksionon mirë, rruga më e mirë për të zgjidhur problemet e shfaqura është biseda me të prekurin direkt.

Në disa nga spitalet ekziston një qendër ndërmjetësimi në të cilën sipas nevojës ju mund të merni këshillime.

Ndërkaq mos e harroni kurrë një lavdërim, nëse gjithçka zhvillohet për kënaqësinë tuaj!



„Zoti mjek, më sqaroni ju lutem...“

E drejta juaj për informim gjithëpërfshirës.

Në pajtim me moshën dhe shkallën zhvillimore, fëmija i juaj duhet informuar në formë të kuptueshme përmes mjekut lidhur me të gjitha kontrollet dhe ndërhyrjet e domosdoshme. Ai ka të drejtë që pikëpamja e tij të dëgjohet dhe, përkatësisht, të merret parasysh.

Për çdo trajtim ose kontroll është i nevojshëm aprovimi prej prindërve. Prandaj keni të drejtën për informacione dhe sqarime gjithëpërfshirëse, të cilat ju bëjnë të aftë për të marrë një vendim. Në rast se fëmija është tashmë i madh, afërsisht pas moshës 12-vjeç, ose i është dashur të përjetojë tashmë shumë ndërhyrje, do të jetë i nevojshëm edhe aprovimi i tij.



„Atmosferë e rëndë“ në dhomën për fëmijë të sëmurë

Ndonjëherë fëmijët reagojnë në mënyrë të pazakonshme kundrejt sëmundjes dhe spitalit.

Në spital ca nga fëmijët sillen me agresivitet dhe refuzim kundrejt prindërve të tyre, ata qajnë ose rezistojnë. Kjo, ndërkaq, kurrsesi nuk do të thotë se ata më me qejf do të rrinin në shtëpi. Një fëmijë që mund t'i shfaqë ndjenjat e tij

hapur është më vonë shpesh më i ekuilibruar se sa një tjetër që lejon në mënyrë pasive të ndodhë gjithçka me të.



Edhe pas daljes nga spitali disa nga fëmijët mund të sjellin goxha kokëçarje. Atyre u duhet që shumë gjëra fillimisht t'i sqarojnë (përpunojnë), kështu edhe përvojën, se jeta e tyre ka ndryshuar nga dita në ditë pa mundësinë që babai ose nëna ta pengonin këtë gjë.

Gjatë javëve të para pas daljes nga spitali ca nga fëmijët kanë probleme me gjumin. Qetësojeni fëmijën tuaj, në rast se zgjohet gjatë natës, pa frikën se do ta lazdroni. Sapo ai të ketë rifituar besimin, probleme të tilla të shumtën zgjidhen vetvetiu. Në rast se, ndërkaq, çrregullimet e tilla zgjasin, drejtojueni një personi kompetent.

„Dhe kush më ndihmon mua?“

Ku mund të gjejnë ndihmë dhe përkrahje prindërit.

Një shtrim në spital është një përvojë e thellë e rrënjësore që shpesh edhe prindërit mund t'i shpjerë në kufirin e tolerancës. Është mirë të dini se ekziston një shoqatë zvicerane me emrin Kind&Spital (Fëmija dhe spitali), së cilës mund t'i drejtoheni me telefon ose me shkrim. Ne ju ndihmojmë me informacione të shumëllojshme, me libra dhe lodra. Mirëpo edhe me propozime konkrete për përgatitje për spital, dhe me udhëzime të dobishme për shtrim. Me përvojën tonë të gjerë e shumëvjeçare ne ju ndihmojmë që të përballeni me problemet e t'i zgjidhni.

I mbështesni të drejtat e fëmijës së sëmurë!

Shoqata zvicerane Kind&Spital (Fëmija dhe spitali) është një asociacion i prindërve, infernieriëve, pediatërve dhe njerëzve tjerë të profesionit që punojnë me fëmijë.

Me 1988 u aprovua Karta evropiane prej 10 pikësh për fëmijët në spital, për të cilën angazhohemi edhe ne, ashtu si dhe për jetësimin e përcaktimeve të Konventës së OKB për të drejtat e fëmijës. Për këtë qëllim madhor ne punojmë së bashku me organizatat e 18 vendeve evropiane në kuadër të krye-shoqatës evropiane EACH European Association for Children in Hospital.

Fëmijëve të sëmurë u mungon një lobi i fuqishëm. Angazhohuni për të drejtat e tyre, bëhuni anëtar i shoqatës zvicerane Kind und Spital (Fëmija dhe spitali).



migesplus

Diese Broschüre ist mit Unterstützung durch migesplus.ch entstanden.
www.migesplus.ch - Gesundheitsinformationen für Migrantinnen und Migranten. Schweizerisches Rotes Kreuz, Departement Gesundheit und Integration.



KIND & SPITAL

Postfach 416, CH-5600 Lenzburg 1
Tel. 062 888 01 77
E-Mail: info@kindundspital.ch
www.kindundspital.ch

Postkonto: 80 - 67141 - 4

Bank: Aarg. Kantonalbank, CH-5001 Aarau
Kto. 16 130.655.36
IBAN: CH03 0076 1016 0130 6553 6

„Po shkoj në spital“



Një udhërrëfyes i vogël për prindër dhe kujdestarë.



KIND & SPITAL FËMIJA & SPITALI

Zvicër, Shoqata mbi të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve në fushën e mjekësisë